



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 193, Datë 18.09.2024

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “HPG ENERGY” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.09.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.1724/8 prot., datë 17.09.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HPG ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1724 prot., datë 02.08.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 160, datë 15.08.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës (në datat 16.08.2024 dhe 17.08.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 26.08.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 1724/4 prot., datë 16.08.2024, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE me shkresën me nr. 1724/3 prot., datë 16.08.2024, i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Në vijim, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1724/5 prot., datë 09.09.2024 dhe nr. 1724/7 prot., datë 16.09.2024, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 2.1 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “HPG ENERGY” sh.p.k.:
 - Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën me nr. 1961 Rep., nr. 1269 Kol., datë 06.04.2023, “Për Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier NGA shoqëria “HPG ENERGY” shpk”;
 - Ka marrë ofertën për rimiratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e shpërndarjes nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., nëpërmjet shkresës së kësaj të fundit nr. nr. 2293/1 prot., datë 15.07.2024;
 - Është pajisur me Vendim për VNM Paraprake, lëshuar më datë 18.07.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të ndërtuar impiantin fotovoltaik me fuqi 2 MW. Rezulton se shoqëria disponon aktualisht një VNM të vlefshme, por për sa i përket fillimit të punimeve, ajo ka bërë me dije se leja e ndërtimit nuk është zbardhur ende. Në të tilla rrethana, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të raportojë çdo 3 (tre) muaj në ERE në lidhje me ecurinë e fillimit të punimeve dhe të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 18.07.2026 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale). Në rast se shoqëria nuk dokumenton fillimin e punimeve brenda kësaj date, ajo duhet të depozitojë në ERE një VNM të re.
- ERE në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar dokumentacionin teknik në lidhje me garancinë e paneleve, e cila është 30 (tridhjetë) vjet. Në këto rrethana, vlerësohet që licenca të jepet për një afat 30 (tridhjetë) vjeçar. Ky afat do të fillojë me vënien në punë të centralit fotovoltaik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Njësinë Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, jo më vonë se data 16.10.2024.

3. Shoqëria duhet të raportojë në ERE çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik dhe të dokumentojë fillimin e tyre brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, pra brenda datës 18.07.2026, përndryshe duhet të depozitohet në ERE VNM Paraprake të re.
4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se depozitohet/konstatohet një dokumentacion i ndryshëm nga ai që ka shërbyer për këtë vendimmarrje.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “HPG ENERGY” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI